



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Shtator 2022

Nr: 188

VENDIM

PËR

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. DASHAMIR MEHMET TAHIRI, KANDIDAT PËR DEPUTET I PROPOZUAR NGA PARTIA LËVIZJA PËR NDRYSHIM, QARKU VLORË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Sot më datë 13.09.2022, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

- Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Dashamir Mehmet Tahiri, kandidat për deputet i propozuar nga Partia Lëvizja për Ndryshim, qarku Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Palë të interesuara: Z. Dashamir Mehmet Tahiri, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të propozuar nga Partia Lëvizja për Ndryshim, qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.
- Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.



Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Kandidati për deputet”.

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Dashamir Mehmet Tahiri, kandidat për deputet i listës shumëmemërore të propozuar nga Partia Lëvizja për Ndryshim, Qarku Vlorë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit numër unik 429.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Lëvizja për Ndryshim, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin “prima facie” pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1777 prot., datë 08.03.2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2515/1 prot., datë 09.03.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kandidati për deputet, z. Dashamir Mehmet Tahiri, nuk ka të regjistruar dënime penale të formës së prerë në sistem, pra nuk është i dënuar.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1778 prot., datë 08.03.2021, ka kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 974/1 prot., datë 13.04.2021, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se kandidati për deputet z. Dashamir Mehmet Tahiri, nuk rezulton të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.
- c. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 158 datë 17.03.2021, vendosi “Miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Lëvizja për Ndryshim për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Dashamir Mehmet Tahiri.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Dashamir Mehmet Tahiri, rezulton se ka deklaruar:

Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit:

Pyetjes 1, “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Me vendimin e datës 28.10.2009, nga Gjykata e Ravenës, Itali është dënuar me 9 (nëntë) muaj, në mungesë, për veprën penale të “Ngarje e automjetit me leje drejtimi të falsifikuar”, parashikuar nga neni 648 i Kodit Penal, Italian, 489 K.P. Ka marrë pafajësi me vendimin e datës 19.11.2019, nga Gjykata e Bolonjës.

Pyetjes 3, “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose në gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një veprë penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Nga data 28.10.2009, është proceduar nga Gjykata e Ravenës, Itali për “Drejtim automjeti me leje të falsifikuar”, ka marrë pafajësi nga Gjykata e Bolonjës, Itali më datë 19.11.2019.

Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se:

Nga viti 1990 deri në vitin 1995 ka qëndruar në Via Kampi 28, Modena, Itali, si emigrant.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2583 prot., datë 24.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 537/55 prot., datë 27.07.2022, Drejtorja e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Dashamir Mehmet Tahiri”.

Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Dashamir Mehmet Tahiri, sipas të cilit konstatohet si me poshtë:

1. Nuk rezulton të ketë gjenealitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;
2. Rezultoi i dënuar me 3 muaj burgim, datë 17.06.1996 me Vendim të Prefekturës së Modenas, për veprën penale "Dëmtim", parashikuar nga neni 635 i Kodit Penal italian (kryer në datën 19/4/1992 në Modena), ka marrë formë të prerë më datë 13/10/1996. Dënimi është pezulluar me kusht në bazë të nenit 163 të Kodit Penal. Më datë 25.05.2017, me Urdhër të Gjykatës me përbërje monokratike të Ravenës, vepra penale, në bazë të nenit 167 të Kodit Penal Italian, është shpallur e shuar;
3. Rezulton i dënuar me burgim prej 9 muajsh dhe me gjobë prej 300 euro, për veprat penale të parashikuara nga neni 489 dhe 648 i Kodit Penal italian me vendimin e datës 29.05.2009 të Gjykatës së Ravenës, Gjyqtari i vetëm i Shkallës së Parë. Në bazë të neneve 174 të Kodit Penal dhe nenit 1 të Ligjit 241/23006, shpall dënimin tërësisht të falur. Me Vendimin nr.7039, datë 19.11.2019 të Gjykatës së Bolonjës i cili ka marrë formë të prerë në datën 04.01.2020, është vendosur: Ndryshimi i pjesshëm i vendimit të dënimit të Gjykatës së Ravenës datë 29.05.2009, ankimuar nga i akuzuari Dashamir Tahiri, deklaroi se nuk duhet të procedohet me veprën e referuar në pikën a) sepse është shuar për shkak të parashkrimit dhe çliron të akuzuarin nga vepra penale e përmendur



në pikën b) sepse fakti nuk ekziston. Konfirmon konfiskimin e dokumentit të sekuestruar, për të cilin urdhërohet ti bashkëngjitet dosjes dhe revokohet vendimi për asgjësimin e tij;

4. Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
5. Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryejën e një vepre penale;
6. Nuk rezultoi të ketë qenë i siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale;
7. Rezultoi që ky shtetas është hetuar në 2 (dy) procedime penale në Shqipëri:

Procedimi penal, nr.1722, viti 2017, për këtë procedim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3835 regj.them, datë 25.10.2018, vendosi: "Pushimin e çështjes penale të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr.1722, viti 2017, regjistruar për veprën penale të "Falsifikim të vulave, stampave ose formularëve", të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal."

Procedimi penal nr.517, të vitit 2003, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr.155, datë 11.05.2004, vendosi: "Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Dashamir Tahiri, për kundravajtjen penale të "Kanosje për shkak të detyrës", të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal." Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.235, datë 14.09.2004, vendosi "Lënien në fuqi të vendimit nr.155, datë 11.05.2004 të Gjykatës së Rrethit Vlorë".

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime, arrestime, hetime, etj).

Z. Dashamir Mehmet Tahiri, kandidat i listës shumemërore të Partisë Lëvizja për Ndryshim në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, qarku Vlorë, nuk ka marrë mandatin e deputetit. Subjekti zgjedhor Partia Lëvizja për Ndryshim referuar neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor nuk ka fituar asnjë mandat në qarkun Vlorë. Në kushtet kur subjekti vetëdeklarues, kandidati i listës shumemërore të Partisë Lëvizja për Ndryshim, nuk do të mund të përfitojë mandat në qarkun e Vlorës për këtë legjislaturë, Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për sa kohë ky subjekt nuk gëzon statusin e deputetit dhe në asnjë rast e për asnjë rrethanë nuk do të mund të marrë këtë funksion publik për të cilin është iniciuar procedura administrative e verifikimit të thelluar. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të moskandidimit, moszgjedhshmërisë apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015. Në rastin objekt shqyrtimi, në analizë dhe zbatim të neneve 10 dhe 11 të ligjit 138/2015, si dhe neneve 90 dhe 95 të ligjit 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"



vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues z. Dashamir Mehmet Tahiri.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

